



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 374. Akti

Nr. 487. Vendimi  
Tiranë, më 15.12.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Brunilda Bekteshi</b>	Kryesuese
<b>Suela Zhegu</b>	Relatore
<b>Firdes Shuli</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jakobs, në datën 13.12.2021, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Arbana Selmanaj**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Pika 5, e nenit 179/ b, të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”:

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Arbana Selmanaj me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 16.12.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 18.6.2019 u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues komisionere Brunilda Bekteshi. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Theo Jakobs.

3. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

5. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar<sup>1</sup>, duke konkluduar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

6. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve

<sup>1</sup>Raport dërguar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.7.2018.

dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar<sup>2</sup>, duke konkluduar mbi “*përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Arbana Selmanaj*”.

7. KLGJ-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar<sup>3</sup> mbi subjektin e rivlerësimit.

8. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

9. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 18.11.2021, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Arbana Selmanaj dhe njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

10. Për një proces të rregullt ligjor, znj. Arbana Selmanaj i janë garantuar të drejtat: (i) për t’u njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; (ii) për t’u njohur me përbërjen e trupit gjykues; si dhe (iii) për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës/shpjegimet mbi rezultatet e hetimit. Subjektit iu dha koha e nevojshme për t’u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj.

11. Znj. Arbana Selmanaj, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat e saj në datën 30.11.2021. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me rezultatet e hetimit, deklaroi se është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

12. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht në datën 7.12.2021.

13. Seanca dëgjimore u zhvilluan në datën 13.12.2021, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jakobs.

14. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, si dhe shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

---

<sup>2</sup>Raporti i DSIK-së, i deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.10.2021, të KDZH-së.

<sup>3</sup>Raporti me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.11.2019, i KLGJ-së.

### **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

15. Subjekti i rivlerësimit Arbana Selmanaj ka qenë bashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, si dhe ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Znj. Arbana Selmanaj ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

16. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

17. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

18. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

19. Ndërsa, sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a. provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b. raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c. deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- d. provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private;
- e. raportin e kontrollit të figurës së dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- f. raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGj-ja;

- g. deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- h. shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

22. Bazuar në nenin 179/b, në nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Arbana Selmanaj, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, u krye mbi bazën e tri kritereve: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI**

Subjekti i rivlerësimit Arbana Selmanaj është bërë subjekt deklarues në vitin 2006 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, ka dorëzuar deklaratat e interesave private për periudhën 2006 – 2016, si dhe deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar për efekt të ligjit nr. 84/2016 (siç quhet ndryshe edhe deklarata *Vetting*).

Komisioni, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore; (ii) burimet e krijimit të kësaj pasurie; (iii) të ardhurat; (iv) shpenzimet; si dhe (v) mundësinë për fshehje të pasurisë dhe deklarim të rremë apo konflikt interesi.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Në deklaratën e pasurisë *Vetting* (shtojca nr. 2) të datës 27.1.2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasuritë, si vijon:

#### **1. Apartament banimi<sup>4</sup>, në Dajt, Tiranë**

Mënyra e fitimit:	me kontratë shitjeje (paraprake) nr. ***, datë 2.4.2016.
Vlera e pasurisë:	45.000 euro (paguar vetëm kësti paraprak 12.000 euro).
Deklaruar në deklaratën <i>Vetting</i> :	e drejtë pasurore që buron nga kontrata paraprake për shitje datë 2.4.2016, me sip. shfrytëzimi 95.6 m <sup>2</sup> dhe sipërfaqe e përbashkët 10.5 m <sup>2</sup> .
Zotërimi:	100 %.
Burimi i krijimit (për pagimin e këstit paraprak):	kursime nga paga dhe përfitim nga heqja dorë e pjesës së apartamentit në bashkëpronësi me prindërit në masën 900.000 lekë sipas aktit noterial nr. ***, datë 1.11.2016.
Në DPV-në e vitit 2016:	është deklaruar si burim për pagimin e këstit paraprak, kursime nga paga dhe përfitim nga heqja dorë e pjesës takuese të apartamentit në masën 900.000 lekë.

<sup>4</sup>Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: kontratë shitje (paraprake) nr. \*\*\*, datë 2.4.2016, me palë shitëse A dhe A.K dhe blerës znj. Arbana Selmanaj, për prenotimin e një apartamenti të përbërë nga 1 dhomë + 1 kuzhinë, me sipërfaqe shfrytëzimi 95.6 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe e përbashkët 10.5 m<sup>2</sup>, të ndodhur në lagjen Q, Komuna Dajt, Tiranë, në vlerën 45.000 euro.

## 1.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

Lidhur me këtë pasuri, subjekti ka shpjeguar<sup>5</sup> se *ky apartament nuk ka kaluar ende në pronësi për shkaqe të pavarura prej saj, pasi kalimi i pronësisë është i kushtëzuar nga miratimi i lejes së shfrytëzimit të objektit*. Gjithashtu, subjekti deklaroi se nuk ka banuar asnjëherë në këtë apartament, pasi nuk është përfunduar plotësisht.

Drejtoria Vendore ASHK Tiranë<sup>6</sup> ka informuar se nuk figurojnë pasuri të regjistruara në emër të subjektit Arbana Selmanaj dhe prindërve të saj.

FSHU-ja<sup>7</sup> ka informuar se nuk rezultoi kontratë për furnizim me energji elektrike në emër të subjektit Arbana Selmanaj dhe prindërve të saj.

UKT-ja<sup>8</sup> ka informuar se nuk rezultoi asnjë e dhënë për regjistrim kontrate shërbimi në emër të subjektit dhe prindërve të saj.

ASHK Lushnjë<sup>9</sup> ka informuar se nga verifikimi elektronik nuk kanë rezultuar pasuri të paluajtshme të regjistruar në emër të subjektit dhe prindërve të saj.

Në dosjen e ILDKPKI-së, subjekti ka depozituar dokumentacionin e pronësisë së apartamentit me nr. \*\*\*, të ndodhur në Lushnjë, në bashkëpronësi të prindërve.

Zyra e Regjistrimit Noterial pranë Ministrisë së Drejtësisë<sup>10</sup> ka konfirmuar disa veprime noteriale<sup>11</sup> të kryera nga subjekti Arbana Selmanaj, por nuk reflektohet akti noterial kontratë shitje (paraprake) i datës 2.4.2016, për apartamentin e prenotuar në Dajt, Tiranë. Komisioni ka kërkuar pranë zyrës së noterit, z. D.H, kopje të njehsuar me origjinalin të kontratës së shitjes datë 2.4.2016, akt i cili është përcjellë nga noteri dhe administruar pranë Komisionit<sup>12</sup>, përmbajtja e të cilit është e njëjtë me kontratën e depozituar nga subjekti.

ISSH-ja<sup>13</sup> ka dërguar informacion mbi të ardhurat e subjektit dhe kontributet e derdhura nga viti 2012 dhe në vijim, si dhe masën e pensioneve të pleqërisë të përfutuara nga prindërit, ku për babain e subjektit pagesat fillojnë nga janari i vitit 2013, ndërsa për nënën fillojnë nga marsi i vitit 2009.

OTP-ja Bank<sup>14</sup> ka konfirmuar llogaritë bankare në emër të subjektit Arbana Selmanaj si vijon:

- a) llogari rrjedhëse në euro, hapur më 2.3.2017, me balancë aktuale në vlerën 42.40 euro;
- b) llogari kredie me këste (standard) në euro, hapur më 8.3.2017, me datë maturimi të kredisë 8.3.2021, në vlerën 18.000 euro, ndërsa në dosje është administruar praktika e kredisë së marrë nga subjekti në datën 25.2.2017, me qëllim blerjen e apartamentit;

<sup>5</sup>E-mail datë 21.10.2021, në përgjigje të pyetësorit datë 13.10.2021.

<sup>6</sup>Shkresat: nr. \*\*\* prot., datë 8.9.2020, e Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 1; nr. \*\*\*prot., datë 15.9.2020, e Drejtorisë Vendore Tiranë Rurale 2; nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2020, e Drejtorisë Vendore Tiranë Jug; nr. \*\*\* prot., datë 18.9.2020, e Drejtorisë Vendore Tiranë Veri.

<sup>7</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.7.2020.

<sup>8</sup>Shkresë nr.k-\*\*\* prot., datë 28.7.2020.

<sup>9</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 9.9.2020.

<sup>10</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2020.

<sup>11</sup>Kontratë qiraje nr. \*\*\*, datë 30.11.2019; kontrate kredie bankare nr. \*\*\*, datë 25.2.2017; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 1.11.2016; kontrate shitje/dhurimi pasurie të luajtshme nr. \*\*\*, datë 25.10.2016.

<sup>12</sup>Shkresë datë 29.10.2021 e noterit D. H, e regjistruar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 3.11.2021.

<sup>13</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 9.7.2020.

<sup>14</sup>Shkresë nr. \*\*\*/tbo-\*\*\* prot., datë 4.8.2020.

- c) Ilogari mbështetëse në lekë, hapur më 23.9.2005 dhe mbyllur më 8.11.2017;
- d) depozitë me afat në lekë, hapur më 15.8.2006 dhe datë maturimi 7.3.2007, në vlerën 200.000 lekë.

## 1.2 Faktet e rezultuara nga hetimi

Nga verifikimi i akteve të administruara pranë Komisionit, ka rezultuar se subjekti Arbana Selmanaj ka prenotuar blerjen e një apartamenti me sip. 95.6 m<sup>2</sup>, në Q, Dajt, Tiranë, në vlerën 45.000 euro, nga shitësit A dhe A.K, të cilët janë pronarë të truallit të dhënë për ndërtim, sipas lejes së ndërtimit nr. \*\*\*, datë 28.12.2010, të KRRT Komuna Dajt, me sipërmarrës “K-SL” sh.p.k. Subjekti ka depozituar kontratën e shitjes (paraprake) datë 2.4.2016<sup>15</sup>, ku dokumentohet prenotimi i këtij apartamenti.

Komisioni hetoi mbi mundësinë e konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit me shitësit e apartamentit A dhe A.K. Referuar shkresës së administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë<sup>16</sup>, ka rezultuar se subjekti, gjatë ushtrimit të detyrës si gjyqtare, nuk ka pasur çështje gjyqësore civile apo penale të shqyrtuara me këta shtetas.

✓ Nga analizimi i akteve të administruara në dosje, nuk u evidentua ndonjë problematikë.

## 1.3 Në lidhje me pagesat për këtë pasuri

Referuar përmbajtjes së kontratës datë 2.4.2016, palët kanë përcaktuar se pagesa e çmimit të shitjes do të kryhej me afate kohore, ku ditën e nënshkrimit të kontratës është paguar shuma 12.000 euro:

- kësti i parë në vlerën 10.000 euro do të paguhej deri më 28.6.2016;
- kësti i dytë në vlerën 10.000 euro do të paguhej deri më 28.9.2016;
- kësti i tretë në vlerën 11.000 euro do të paguhej deri më 28.12.2016, në momentin e dorëzimit të apartamentit;
- ndërsa diferenca në vlerën 2.000 euro do të paguhej në momentin e pajisjes me certifikatë pronësie dhe lidhjes së kontratës përfundimtare të shitjes.

Në DPV-në e vitit 2016, në rubrikën e detyrimeve financiare, subjekti ka deklaruar se për blerjen e apartamentit është shlyer shuma 12.000 euro dhe ndërsa detyrimi i mbetur i pashlyer është në vlerën 33.000 euro. Nga verifikimi i DPV-ve vijuese ka rezultuar se subjekti ka deklaruar pagesat faktike të kryera dhe detyrimin e mbetur.

Komisioni i ka kërkuar<sup>17</sup> subjektit të provojë pagesat e kryera për blerjen e apartamentit dhe subjekti<sup>18</sup> ka shpjeguar, ndër të tjera, se:

---

<sup>15</sup>Dokumentacioni i depozituar nga subjekti dhe i regjistruar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 13.2.2020: kontratë shitje (paraprake) nr. \*\*\*, datë 2.4.2016, bashkëlidhur ndodhen në vendimi nr. \*\*\*, datë 28.12.2010, i KRRT-së për leje sheshi dhe leje ndërtimi për objektin “godinë banimi dhe shërbimi 5 kat + nëncati + 1 kt parkim nëntokë”, pronë e z. A.K me subjekt ndërtues “K-SL” sh.p.k.; vendim i KRRT-së për miratimin e destinacionit të shesh ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij; mandatpagese datë 2.4.2016.

<sup>16</sup>Shkresë nr.\*\*\* prot., date 17.9.2021.

<sup>17</sup>Përmes pyetësorit me e-mail datë 13.10.2021.

<sup>18</sup>Në përgjigje të pyetësorit datë 13.10.2021, subjekti ka depozituar me e-mail datë 21.10.2021, dokumentet si vijon: kopje e ekstraktit bankar nga “OTP Bank” për periudhën 1.3.2017 – 21.10.2021; mandat bankar datë 2.3.2017, i “Tirana Bank” për shumën 322.944 lekë dhe mandat i konvertimi të shumës në euro; mandatarkëtimi datë 2.3.2017, i “Societe Generale Albania” bank për arkëtimin e shumës 2.000 euro; dublikatë datë 7.10.2020, e depozitimit të shumës 8.000 euro e “Intesa

**i.** Pagesa paraprake me shumë 12.000 euro është kryer *cash*, përmes mandatpagesës datë 2.4.2016 të bashkëngjitur kontratës paraprake të shitjes. Në dosjen e ILDKPKI-së është administruar shkresa datë 26.8.2017<sup>19</sup>, e lëshuar nga shitësit e apartamentit (shtetasit A dhe A.K), të cilët kanë konfirmuar pagesën në vlerën 12.000 euro, të kryer nga subjekti Arbana Selmanaj deri më 26.1.2017, ndërsa detyrimi i papaguar deri në këtë datë është në vlerën 33.000 euro.

**ii.** Për sa i përket pjesës tjetër të pagesave, subjekti ka shpjeguar se: *“Pranë bankës ‘Societe General Albania’, sot ‘OTP Bank’, kam aplikuar për kredi dhe pas miratimit të saj është çelur llogaria për disbursimin dhe shlyerjen e kredisë. Vlera e saj është në shumën 18.000 euro. Pagesa e kryer për llogari të shitësit është 20.000 euro”*. Në vijim, subjekti ka saktësuar se: *“Shuma prej 2.000 euro është shuma e tërhequr prej 322.944 lekë, të cilat kanë qenë të depozituara në llogarinë time të kursimit. Kjo shumë është tërhequr në datën 2.3.2017 dhe po në këtë datë është depozituar pranë OTP-së”*.

Subjekti ka depozituar si dokumentacion mbështetës kopje nga statementi bankar i marrë nga “OTP Bank” dhe kopje të mandateve bankare datë 2.3.2017, të marra nga “Tirana Bank” dhe “OTP Bank”, ku evidentohet:

- tërheqja e shumës 322.944 lekë dhe konvertimi në euro e kryer më 2.3.2017, në “Tirana Bank”;
- derdhja *cash* e shumës 2.000 euro në bankën “Societe Generale Albania” (sot “OTP Bank”), në datën 2.3.2017;
- disbursimi i kredisë në vlerën 18.000 euro nga “OTP Bank” në datën 8.3.2017.

Shumat e sipërpërmendura u kanë kaluar shitësve përmes llogarisë bankare me 2 transhe, ku vlera 10.000 euro u ka kaluar në datën 8.3.2017 dhe vlera 10.000 euro në datën 5.7.2017.

**iii.** Lidhur me pagesat e tjera, subjekti ka shpjeguar se: *“Një pjesë tjetër e detyrimit ndaj shitësit është kryer nëpërmjet transfertës bankare me shumë 8.000 euro, të cilat janë tërhequr më 7.10.2020, pranë ‘Tirana Bank’ nga llogaria ime e kursimit dhe kanë kaluar në llogarinë e shitësit në ‘Intesa Sanpaolo Bank’. Në datën 19.3.2021 kam shlyer edhe detyrimin e fundit të çmimit në shumën 5.000 euro”*.

Subjekti ka depozituar dublikatat datë 7.10.2020 dhe 19.3.2021, të lëshuara nga “Intesa Sanpaolo Bank”, ku evidentohet depozitimi *cash* i këtyre shumave për llogari të shoqërisë së shitësit, z. A.K.

✓ Nga analizimi i dokumentacionit bankar nuk evidentohen problematika.

### **1.3.1 Në lidhje me kredinë e marrë për blerjen e apartamentit**

Nga verifikimi i dokumentacionit të përcjellë nga “OTP Bank”<sup>20</sup> provohet kredia e marrë nga subjekti në shumën 18.000 euro, me kontratën e kredisë bankare nr. \*\*\*, datë 25.2.2017, me

---

Sanpaolo Bank”; dublikatë datë 19.3.2021 e depozitimit të shumës 3.000 euro e “Intesa Sanpaolo Bank”; dublikatë datë 19.3.2021 depozitimit të shumës 2.200 e “Intesa Sanpaolo Bank”.

<sup>19</sup>Në përgjigje të kërkesës nr. \*\*\* prot., datë 21.7.2017, të ILDKPKI-së.

<sup>20</sup>Shkresë nr. \*\*\*/tbo-\*\* prot., datë 4.8.2020, “OTP Bank” ka dërguar dokumentacionin si vijon:

- kontratë kredie bankare afatgjate nr. \*\*\*, datë 25.2.2017;
- kontratë hipotekimi nr. \*\*\*, datë 25.2.2017;
- Vërtetimin nga Dokumentet Hipotekore nr. \*\*\*, datë 30.9.2016 për pasurinë nr.\*\*\*, apartament me sip.76 m<sup>2</sup> në Lushnjë;



afat 10-vjeçar, me qëllim blerjen e një apartamenti. Kredia është disbursuar më 8.3.2017. Sipas kontratës së hipotekimit nr. \*\*\*, datë 25.2.2017, si kolateral është vendosur apartamenti në Lushnjë, në pronësi të prindërve të subjektit.

- ✓ Referuar historikut të lëvizjeve të llogarisë së subjektit në “OTP Bank”, evidentohet kalimi i shumave, 10.000 euro, në datën 8.3.2017 dhe 10.000 euro në datën 5.7.2017, në favor të shitësve të apartamentit.

#### **1.4 Burimi i krijimit për pagesën 12.000 euro**

Në deklaratën *Vetting*, për pagesën e kështit paraprak për blerjen e apartamentit në shumën 12.000 euro, subjekti, si burim krijimi, ka deklaruar:

- a. kursimet nga paga si gjyqtare;
- b. të ardhurat e përfituara nga heqja dorë nga pjesa takuese e apartamentit në bashkëpronësi me prindërit në masën 900.000 lekë, sipas aktit noterial nr. \*\*\*, datë 1.11.2016.

##### *a. Në lidhje me kursimet nga paga si gjyqtare*

Komisioni i ka kërkuar<sup>21</sup> subjektit të saktësojë nëse kursimet e deklaruara prej tij, në DPV-të<sup>22</sup> e viteve 2013 dhe 2015, janë *cash* apo në llogari bankare. Subjekti ka sqaruar në shpjegime se gjendjet *cash* në fund të vitit, si dhe gjendja *cash* e akumuluar deri në dhjetor të vitit 2015 është përdorur për pagesën pjesore të kështit të parë për blerjen e apartamentit.

Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore evidentohet se subjekti ka deklaruar gjendjet *cash* që nga viti 2006 e në vijim. Kursimet *cash* të deklaruara deri në vitin 2015 janë në shumën 1.340.000 lekë. Në DPV-në e vitit 2016 subjekti nuk ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash*, por si burim për pagesën e kryer ka deklaruar: “*kursimet nga paga*”.

##### *b. Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga heqja dorë e pjesës takuese të apartamentit në bashkëpronësi me prindërit*

Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka shpjeguar se *për pagesën e kryer 12.000 euro në ditën e lidhjes së kontratës, parapagim si kësht i parë i çmimit të apartamentit. Nga këto të holla, 6.000 euro janë kursime nga paga dhe 6.000 euro të tjera janë nga kompesimi prej 9.000.000 lekësh që prindërit i kanë shlyer, pasi ka hequr dorë nga pronësia e apartamentit me nr. \*\*\*, e ndodhur në zonën kadastrale \*\*\*, me sip. 76 m<sup>2</sup>, lagjja “L.Dh” Lushnjë. Për sa i përket burimit të të hollave të dhëna nga prindërit, siç ata kanë deklaruar, ato janë të holla të mbledhura në vite nga kursimet dhe të ardhurat e djalit të tyre emigrant për disa vite në Greqi.*

Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 1.11.2016, të nënshkruar nga prindërit e saj, të cilët deklarojnë se *në muajin mars 2016 i kanë dhënë vajzës së tyre Arbana Selmanaj shumën 900.000 lekë, kursime të tyre dhe të djalit A.S, si vlerë e pjesës së saj takuese mbi pasurinë apartament me sip. 76 m<sup>2</sup>, i ndodhur në Lushnjë, meqenëse hoqi dorë nga çdo pretendim mbi këtë apartament.*

- Historik i lëvizjeve të llogarisë së subjektit në LEK nga data 23.9.2005 – 30.7.2020,

- Historik i lëvizjeve të llogarisë së kredisë së subjektit në euro nga data 2.3.2017 – 30.7.2020.

<sup>21</sup>E-mail datë 13.10.2021.

<sup>22</sup> DPV e vitit 2013 deklaruar “kursime nga paga në shumën 200.000 lekë”.

DPV e vitit 2015 deklaruar “shtesë e kursimeve nga të ardhurat nga paga në shumën 540.000 lekë”.

**1.5 Komisioni analizoi të ardhurat e ligjshme të prindërve**, për shumën 900.000 lekë të dhuruar subjektit, me burim krijimi: kursimet e realizuara nga prindërit, ndër vite, dhe vëllai i subjektit, z. A.S.

*i. Në lidhje me të ardhurat e prindërve të subjektit*

Komisioni ka administruar të dhënat nga ISSH-ja<sup>23</sup> mbi të ardhurat e pensionit të pleqërisë të prindërve të subjektit, ku për babain E.S pagesat fillojnë nga janari i vitit 2013, ndërsa për nënën M.S fillojnë nga marsi i vitit 2009. Subjekti ka depozituar dokumentacion mbështetës<sup>24</sup>, të lëshuar nga ISSH-ja mbi të ardhurat e pensionit të prindërve. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar<sup>25</sup> edhe punësimet e prindërve ndër vite, si vijon: *“Nëna ka qenë e punësuar si ekonomiste që prej vitit 1968 e deri në kohën e daljes së saj në pension. Rezultojnë të provuara kontributet e saj në sigurimet shoqërore nga dita e fillimit të punës deri në vitin 1997. Kontributet pas vitit 1997 ka qenë e pamundur të provohen për shkak të mungesës së dokumentacionit ose mosderdhjes së sigurimeve nga punëdhënësi”*.

Sa i takon punësimin të babait, subjekti ka shpjeguar se: *“Babai është punësuar që prej vitit 1967 në qytetin e Lushnjës, si punëtor investimesh, përgjegjës blloku, inventarizues, magazinier dhe së fundi përgjegjës transporti deri më 31.5.1994. Në vazhdim ai ka punuar si menaxher i një njësie shërbimi dhe tregtimi në qytetin e Lushnjës, njësi e cila më pas ka mbyllur aktivitetin. Ka rezultuar se punëdhënësi për këtë periudhë nuk ka derdhur kontributet shoqërore për punëmarrësit e tij”*.

*ii. Në lidhje me të ardhurat e vëllait nga emigracioni në Greqi*

Subjekti ka shpjeguar, në përgjigje të pyetësorit standard, se vëllai A.S, gjatë punësimit si emigrant, ka qenë i siguruar dhe, për rrjedhojë, ka paguar detyrimet tatimore, për të cilin ka paraqitur dokumentacion (në gjuhën greke), si dhe pasaportën ku reflektohen lejet e qëndrimit në shtetin grek për arsye pune.

Komisioni i ka kërkuar subjektit<sup>26</sup> të provojë punësimin e vëllait në shtetin grek dhe të dokumentojë të ardhurat e ligjshme të tij. Subjekti ka shpjeguar<sup>27</sup> se: *“Të ardhurat e vëllait tim A. S burojnë nga puna e tij si emigrant ekonomik në shtetin grek që prej vitit 1997. Nga dokumentacioni i administruar rezulton i regjistruar si punëmarrës nga viti 2003 e në vijim”*. Subjekti ka depozituar dokumentacion mbështetës<sup>28</sup> të përkthyer lidhur me lejen e punës së

<sup>23</sup>Shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.7.2020.

<sup>24</sup> Dokumentacion i depozituar nga subjekti, regjistruar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot, datë 21.10.2021 si më poshtë:

- Vërtetim nr.\*\*\*prot, datë 27.09.2021 i lëshuar nga ISSH, e cila konfirmon të ardhurat e realizuara nga babai i subjektit z. E. S nga pensioni i pleqërisë duke filluar nga data 2.1.2013.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të lëshuar nga ISSH për babain e subjektit z. E.S për të ardhurat e realizuara në periudhën qershor 1994 – maj 1995.
- Vërtetim për vjetërsi në punë për efekt pensioni e lëshuar nga ISSH me nr.\*\*\* prot, datë 11.2.2013 për z. E.S, shoqëruar dhe me librezë pune, ku evidentohet punësimi i babait të subjektit në periudhën 1967 – 1987, pranë ish Ndërmarrjes Bashkimi NTSH si punëtor investimesh, përgjegjës blloku, inventarizues dhe magazinier.
- Vërtetim nr.\*\*\* prot, datë 28.9.2021 i lëshuar nga ISSH, e cila konfirmon të ardhurat e realizuara nga nëna e subjektit zj. M.S nga pensioni i pleqërisë duke filluar nga data 3.3.2009.

<sup>25</sup> me email datë 19.10.2021, në përgjigje të pyetësorit datë 23.9.2021

<sup>26</sup> përmes pyetësorit datë 23.9.2021

<sup>27</sup> me email datë 29.9.2021, në përgjigje të pyetësorit datë 23.9.2021.

<sup>28</sup> Dokumentacion i depozituar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit datë 23.09.2021, regjistruar pranë Komisionit me nr.\*\*\* prot, datë 21.10.2014:

vëllait të saj, si dhe me pagesat për kontributet shoqërore dhe shëndetësore për periudhën 2005 – 2010. Gjithashtu, subjekti ka depozituar<sup>29</sup> dokumentacion shtesë lidhur me të ardhurat e vëllait, të lëshuara nga sigurimet shoqërore të shtetit grek, me vulë apostile.

Nga verifikimi i pasaportës së vëllait të subjektit, z. A.S<sup>30</sup>, kanë rezultuar hyrje- dalje në shtetin grek, si dhe 5 viza/leje qëndrimi nga shteti grek në periudhën 2003 – 2010.

Komisioni verifikoi, përmes të dhënave të gjeneruara nga sistemi *TIMS* (i cili gjeneron informacion nga viti 2004), mbi hyrje - daljet e vëllait të subjektit, z. A.S, në territorin shqiptar dhe në shtetin grek, ku rezultoi se ka hyrje - dalje nga viti 2004 e në vijim në shtetin grek, kryesisht nga pika e Kakavijës.

## 1.6 Analiza financiare

Komisioni analizoi burimet e ligjshme që kanë shërbyer për pagesën e shumës 12.000 euro, e konvertuar në shumën 1.623.240 lekë, për prenotimin e apartamentit në prill të vitit 2016.

Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim për pagesën e këstit paraprak, kursimet nga paga dhe të ardhurat e përfituara nga heqja dorë e pjesës takuese të apartamentit në bashkëpronësi me prindërit në shumën 900.000 lekë.

### 1.6.1 Analiza mbi mundësitë e prindërve për të dhënë shumën 900.000 lekë

Nga analizimi i dokumentacionit provues në lidhje me të ardhurat e prindërve dhe vëllait emigrant në Greqi, ka rezultuar se:

- 
- Vërtetim përkthimi nr. \*\*\* rep. datë 29.09.2021 i Faturës së Pagesës së Kontributeve të Sigurimeve e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Bujqësore, për gjashtë mujorin e parë të vitit 2005;
  - Vërtetim përkthimi nr. \*\*\* rep., datë 29.09.2021 i Faturës së Pagesës së Kontributeve të Sigurimeve e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Bujqësore, për gjashtë mujorin e parë të vitit 2006;
  - Vërtetim përkthimi nr. \*\*\* rep., datë 29.09.2021 i Faturës së Pagesës së Kontributeve të Sigurimeve e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Bujqësore, për gjashtë mujorin e parë të vitit 2007;
  - Vërtetim përkthimi nr. \*\*\* rep, datë 29.09.2021 i Faturës së Pagesës së Kontributeve të Sigurimeve e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Bujqësore, për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2007;
  - Vërtetim përkthimi nr. \*\*\* rep, datë 29.09.2021, i Faturës së Pagesës së Kontributeve të Sigurimeve e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Bujqësore, për gjashtë mujorin e parë të vitit 2008;
  - Vërtetim përkthimi nr. \*\*\* rep, datë 29.09.2021 i Faturës së Pagesës së Kontributeve të Sigurimeve e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Bujqësore, për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2008;
  - Vërtetim përkthimi nr. \*\*\* rep, datë 29.09.2021 i Faturës së Pagesës së Kontributeve të Sigurimeve e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Bujqësore, për gjashtë mujorin e parë të vitit 2009;
  - Vërtetim përkthimi nr. \*\*\* rep, datë 29.09.2021, i Faturës së Pagesës së Kontributeve të Sigurimeve e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Bujqësore, për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2009;
  - Vërtetim përkthimi nr. \*\*\* rep, datë 29.09.2021 i Faturës së Pagesës së Kontributeve të Sigurimeve e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Bujqësore, për gjashtë mujorin e parë të vitit 2010;
  - Vërtetim përkthimi nr. \*\*\* rep, datë 29.09.2021, i pasaportës së shtetasit A.S për lejët e punës nga administrata e Republikës së Greqisë nga data 10.09.2003 – 10.10.2010;
  - Vërtetim përkthimi nr. rep \*\*\*, datë 29.09.2021 i Vërtetimit të lejës së qëndrimit në Republikën e Greqisë;
  - Vërtetim Përkthimi nr.rep.\*\*\*, datë 18.10.2021 i ekstraktit të Pasqyrës Financiare të Tatimit mbi të ardhurat e personave fizikë, për vitin financiar 2008;
  - Vërtetim Përkthimi nr.rep.\*\*\*, datë 18.10.2021 i ekstraktit të Pasqyrës Financiare të Yatimit mbi të ardhurat e personave fizikë, për vitin financiar 2009.

<sup>29</sup> përmes emailit datë 12.11.2021

<sup>30</sup> Kopje e pasaportës së shtetasit z. AS, e depozituar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit standard, ku rezultojnë hyrje- dalje në shtetin grek dhe 5 viza/ lejë qëndrimi në periudhën 2003- 2010, konkretisht: 10.09.2003 - 20.01.2004, 09.01.2004 - 10.10.2004, 20.10.2004 - 10.10.2006, 30.01.2007 - 10.10.2008, 27.03.2009 - 10.10.2010.

1. Të ardhurat e prindërve si pensionistë janë në kufirin minimal të shpenzimeve jetike.
2. Vëllai i subjektit rezulton si i vetësiguruar në sektorin privat dhe në bazë të dokumentacionit të depozituar për periudhën 2005 – 2010, nuk mund të përlloraget saktë sa kanë qenë të ardhurat *neto* të përfituara nga punësimi. Kjo pasi dokumentet e depozituara janë disa fatura pagesash për kontribute të lëshuara nga Instituti i Sigurimeve Bujqësore në Greqi.

Për pasojë, Komisioni e ka të pamundur të kryejë një analizë financiare mbi mundësinë e vëllait me të ardhurat e siguruara në shtetin grek.

**Përfundimisht, në lidhje me të ardhurat e ligjshme të familjarëve të saj, ka rezultuar mungesë burimesh të ligjshme për dhënien e shumës 900.000 lekë.**

### 1.6.2 Analiza në lidhje me kursimet *cash*

Komisioni analizoi kursimet *cash* të deklaruara në deklaratimet periodike vjetore në vite dhe deri në dhjetor të vitit 2015 janë në shumën 1.340.000 lekë. Komisioni, nisur nga fakti se në DPV-në e vitit 2016 subjekti nuk ka deklaruar pakësimin e kursimeve *cash*, për pagesën e kryer më 2.4.2016, në tabelën vijuese, nuk janë përlloragitur si burim kursimet *cash* në vite.

#### **Analiza financiare për pagesën me shumë 12.000 euro në prill të vitit 2016**

Përshkrimi	Periudha janar – 2.4.2016
<b>Pasuri</b>	<b>1 668 344</b>
Pagesë kësti I për apartamentin	1 623 240
<b>Diferencë likuiditeti</b>	<b>45 104</b>
Detyrim për apartamentin	4 463 910
<b>Pasuri <i>neto</i></b>	<b>1 668 344</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>259 633</b>
Të ardhura nga paga	259 633
<b>Shpenzime</b>	<b>82 773</b>
Shpenzime jetese	58 773
Shpenzime qiraje Vlorë	24 000
<b>Rezultati financiar</b>	<b>- 1 491 484</b>

Nga analiza financiare e kryer ka rezultuar një balancë negative në shumën **1.491.484 lekë**, duke analizuar të ardhurat e subjektit nga janari deri më 2.4.2016.

### 1.6 Konstatime të Komisionit për këtë pasuri

- Deklarim i pasaktë lidhur me deklarin e subjektit për përfitimin e shumës 900.000 lekë, për shkak të heqjes dorë nga bashkëpronësia e apartamentit në Lushnjë, pasi referuar akteve<sup>31</sup> ligjore nga privatizimi i apartamentit evidentohet se përfitues janë vetëm prindërit

<sup>31</sup> Kontrata për Privatizimin e Banesës dt.29.05.1995; Kërkesa në formë Deklarate e Komisionit të Privatizimit të Banesave Shtetërore; Vërtetim i Ndërmarrjes Komunale Banesa Lushnjë datë 09.07.1993, mandate arkëtimi; Formulati nr.2 “Treguesit kryesorë per apartamentin” datë 17.06.1993; Vendimi nr.\*\*\*, datë 02.10.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë; Vendimi nr.\*\*, datë 21.01.2016 të Gjykatës së Apelit Vlorë; Vërtetim nga Dokumentet Hipotekor nr.\*\*\*, datë 30.09.2016 të lëshuar nga ZVRPP Lushnjë, për pasurinë apartament (2+1) me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup> me nr. \*\*\*, në adresën Lgj. “L.Dh”, Lushnjë; Vërtetim nr.\*\*\* prot, datë 20.01.2017 të lëshuar nga ZVRPP Lushnjë.

e subjektit dhe znj. Arbana Selmanaj nuk figuron bashkëpronare me ndonjë pjesë takuese në këtë pasuri.

- Nga analizimi i të ardhurave të ligjshme të familjarëve ka rezultuar mungesë burimesh të ligjshme për dhënien e shumës 900.000 lekë.
- Balancë negative në shumën **1.491.484 lekë** për pagesën e kryer në prill të vitit 2016.
- Subjekti nuk ka deklaruar pakësim e kursimeve *cash* në DPV-në e vitit 2016.

**Në lidhje me këto konstatime, Komisioni i ngarkoi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikën 5, të Nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.**

### **1.7 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

*i. Në lidhje me apartamentin e prindërve të ndodhur në Lushnjë, përmes prapësimeve të depozituara në datën 30.11.2021, subjekti pretendoi se e drejta e pronësisë mbi këtë apartament i ka kaluar në bazë të ligjit dhe kontratës për privatizimin e banesave e lidhur mes Ndërmarrje Komonale Banesave dhe babait të saj E.S, e cila ka ngelur e paregjistruar në ZVRPP-në Lushnjë, për shkak të moshartimit të saj pranë një zyre noteriale dhe, për rrjedhojë, procedura e privatizimit nuk është përfunduar. Pavarësisht faktit se sendi nuk ka qenë i regjistruar, subjekti shpjegoi se në deklaratën e interesave private, përpara fillimit të detyrës, ka deklaruar faktin e bashkëpronësisë së këtij apartamenti.*

Subjekti shpjegoi edhe në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 13.12.2021, se në aktin bashkëngjitur kontratës krahas emrave të prindërve, punonjësit e Komisionit të Privatizimit kanë shënuar edhe emrin e saj si përfituese e të drejtës reale të bashkëpronësisë në këtë apartament, si persona madhorë në momentin e kalimit të pronësisë nga shitësi te blerësi, në bazë të neneve 9 dhe 20 të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992.

Sipas subjektit, për regjistrimin e kontratës së shitblerjes së apartamentit, zgjidhja më e mirë juridike ishte ngritja e padisë për fitimin e pronësisë me anë të parashkrimit fitues me titull. Subjekti pretendoi se ka hequr dorë nga e drejta për qenë palë ndërgjyqëse në këtë padi me qëllim që sendi të regjistrohej në emër të prindërve të saj, nisur nga dëshira e prindërve të cilët sipas të drejtës zakonore shqiptare, dëshironin që këtë apartament t'ia linin djalit të tyre, me të cilin aktualisht jetojnë.

Në mbështetje të prapësimeve të saj, subjekti ka ridepozituar kontratën e privatizimit të banesës të shoqëruar me kërkesën në formë deklarate të babait E.S, drejtuar Komisionit të Privatizimit të Banesave Shtetërore pranë NK Lushnjë<sup>32</sup>.

*ii. Lidhur me mundësinë financiare të prindërve dhe vëllait për të kursyer shumën 900.000 lekë, në prapësimet e depozituara në datën 30.11.2021, subjekti ka shpjeguar se vëllai i saj ka qenë i punësuar në shtetin grek në periudhën 2003 – 2011, ku ka derdhur kontributet përkatëse*

---

<sup>32</sup>Dokumentacion i depozituar nga subjekti me prapësimet e datës 30.11.2021: Kontratë për privatizimin e banesës (Formular nr. 3) dt.29.8.1995 midis palës shitëse NK Banesa dhe qiramarrësit E.S; Kërkesë në formë deklarate e z. E.S paraqitur në Komisionin e Privatizimit të Banesave Shtetërore pranë NK Lushnjë; Vërtetim dt. 09.07.1993 i Ndërmarrjes së Komunales e Banesave Lushnjë; Mandat arkëtim nr. \*\*\*, dt. 9.7.1993 për shumën 12 560 lekë; Mandat arkëtim nr. \*\*\*, dt. 9.7.1993 për shumën 25 lekë; Mandat arkëtim nr. \*\*\*, dt. 9.7.1993 për shumën 200 lekë; Formulari nr. 2 “Treguesit kryesorë të apartamentit”; Planvendosje të sipërfaqjes së apartamentit.

në fondin e pensioneve të këtij shteti, si dhe ka paguar kontributet për sigurimin shëndetësor të tij. Subjekti ka shpjeguar se e ka pasur të pamundur të sigurojë akte me anë të të cilave të provohet saktësisht shuma e të ardhurave vjetore të vëllait, për shkaqe të pavarura nga vullneti i saj, pasi ka mbi 10 vjet që vëllai është kthyer nga emigrimi.

Në mbështetje të prapësimeve të saj, subjekti ka depozituar në Komision:

- vërtetimin<sup>33</sup> e lëshuar nga Departamenti Rajonal i Bujqve të Kretës, i përkthyer dhe legalizuar me vulë apostile, i cili konfirmon faktin se në periudhën 1.10.2003 – 31.12.2011, vëllai, z. A.S, ka qenë i punësuar në shtetin grek dhe i siguruar si punëtor toke (i vetëpunësuar/regjistruar si person fizik) në Regjistrin e të Siguruarve të Degës së Sigurimit Kryesor;
- dy dokumente<sup>34</sup> të përkthyer nga noteri, por të palegalizuara me vulë apostile, të cilat sipas subjektit janë të printuara nga sistemi, duke pretenduar se të ardhurat e vëllait për vitin 2008 kanë qenë në shumën 12.000 euro dhe në vitin 2009, po në shumën 12.000 euro. Sipas subjektit, referuar këtyre deklaratave, nuk ka detyrime tatimore për tatimet për nivelin e shumës së të ardhurave të deklaruara.

Subjekti ka shpjeguar se, për realizimin e të ardhurave të mësipërme, janë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas faturave përkatëse të depozituara në Komision, të cilat për dy vitet 2008 dhe 2009 janë në total në vlerën 914.72 euro.

Subjekti ka përllogaritur mundësinë për kursim të vëllait A.S në fund të vitit 2009, duke përfshirë shpenzimet jetike në shtetin grek<sup>35</sup> rreth 6.387 euro/vit (ose 532.25 euro/muaj), ku, sipas saj, mundësia për kursim ka qenë në shumën 10.311.28 euro, konvertuar në shumën ekuivalente 1.422.545 lekë (me kursin e këmbimit në fund të vitit 2009).

Subjekti nuk ka arritur të sigurojë informacion për të ardhurat e deklaruara në vitet e tjera të vëllait, por këto të ardhura, sipas saj, nuk e kanë kaluar vlerën 10.000 euro. Për rrjedhojë, subjekti kërkon që Komisioni të ndjekë një metodologji alternative përllogaritjeje, sikurse veprohet për tatimpaguesit e biznesit të vogël në Shqipëri.

Si përfundim, subjekti pretendon se vëllai i saj ka pasur mundësi financiare të kursejë shumën 1.422.545 lekë, duke marrë në vlerësim vetëm përllogaritjet e kryera për vitet 2008 dhe 2009 dhe, për rrjedhojë, mundësia për kursim i prindërve dhe vëllait është në shumën 997.160 lekë, fakt i cili provon mundësinë financiare të tyre për dhënien e shumës 900.000 lekë në vitin 2016.

*iii. Në lidhje me kursimet nga paga të subjektit, në prapësimet e datës 30.11.2021, subjekti ka shpjeguar se në deklaratën Vetting dhe në DPV-në e vitit 2016 ka deklaruar të njëjtin burim për pagesën e këstit paraprak për blerjen e apartamentit dhe nuk ka pasur si qëllim t'i referohet kursimeve për harkun kohor 1.1.2016 - 2.4.2016, që është edhe momenti i blerjes.*

---

<sup>33</sup>Dokument i depozituar nga subjekti me prapësimet e datës 30.11.2021: Vërtetim i Periudhës së Sigurimit nr.prot. \*\*\*, datë 29.10.2021 i lëshuar nga Departamenti Rajonal i Bujqve të Kretës, për shtetasin z. A.S, i legalizuar me vulë Apostile në datë 12.11.2021 dhe e përkthyer me Vërtetim Përkthimi nr.rep.\*\*\*, dt.18.11.2021.

<sup>34</sup> Deklarata e bilancit të tatimit mbi të ardhurat personale të personave fizik bazuar në paraqitjen e deklaratës fillestare për vitin 2008 i përkthyer me Vërtetim Përkthimi nr.rep.\*\*\*, datë 18.11.2021; Deklarata e bilancit të tatimit mbi të ardhurat personale të personave fizik bazuar në paraqitjen e deklaratës fillestare për vitin 2009 i përkthyer me Vërtetim Përkthimi nr.rep.\*\*\*, datë 18.11.2021.

<sup>35</sup>Sipas të dhënave të Shërbimit Statistikor Grek (<https://www.statistics.gr/el/statistics/-/publication/SFA10/>)

Subjekti ka shpjeguar se kur ka deklaruar “kursime nga paga” ka pasur si qëllim të deklarojë të gjitha dhe të vetmet kursime të jetës dhe të punës së saj, duke argumentuar se nuk mund të deklaronte kursime disa herë më shumë se të ardhurat nga paga, të cilat deri në datën e pagesës së këstit të çmimit të apartamentit të prenotuar kanë qenë në shumën 259.633 lekë.

Subjekti kërkoi që në analizën financiare të kryer nga Komisioni të mbahen në konsideratë kursimet nga paga, të cilat kanë qenë gjendje *cash* në fund të vitit 2015, të cilat nga përlllogaritjet e kryera edhe nga Komisioni kanë qenë në shumën 1.210.000 lekë.

Lidhur me konstatimin e Komisionit se subjekti nuk ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash* në DPV-në e vitit 2016, subjekti ka shpjeguar se në të njëjtën mënyrë ka deklaruar edhe në periudhat paraardhëse si në DPV-në e vitit 2013, ku ka deklaruar “kursime nga paga në shumën 200.000 lekë”, duke iu referuar shtesës së gjendjes *cash* me shumën 200.000, por nuk ka përdorur fjalën “shtesë”, por “kursime” për të treguar ndryshimin në rritje të gjendjes *cash*.

Subjekti ka argumentuar se deklarimi si burim krijimi i “kursimeve nga paga” ka qenë në kontekstin e pakësimit të gjendjes *cash*, që shërbeu për përballimin e një pjese të këstit, pasi nuk ka pasur asnjë shpenzim tjetër të konsiderueshëm që mund të përdorte gjendjen *cash*.

Subjekti ka argumentuar se bazuar në qëndrimin e organeve të rivlerësimit<sup>36</sup> është konsoliduar tashmë qëndrimi se pasaktësitë në DPV-të vjetore nuk përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore, nëse pasaktësia është e palidhur me fshehjen e pasurisë dhe është pasojë e një perceptimi të gabuar dhe në mirëbesim të subjektit të rivlerësimit.

Si përfundim, subjekti pretendon që në analizën financiare të kryer nga Komisioni për pagesën e shumës 12.000 euro deri në datën 2.4.2016 duhet të merret në konsideratë: (i) vlera 900.000 lekë, dhënë prej familjes së origjinës; si dhe (ii) pakësimi i gjendjes *cash* në shumën 723.240 lekë, pasi ka deklaruar se kanë qenë kursimet nga paga ato që kanë shërbyer si një ndër burimet për përballimin e këstit të parë, ku ditën e kryerjes së pagesës më 2.4.2016, përveç një vlere të vogël të kursyer nga pagat e vitit 2016, dispononte edhe likuiditetin *cash* në shumën 1.210.000 lekë (pra shuma *cash* gjendje në datën 1.1.2016), të kursyer në vitet e shkuara.

## **1.8 Vlerësimi i Komisionit**

Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar në raport me shpjegimet e subjektit në lidhje me mënyrën e fitimit dhe regjistrimit të pasurisë së prindërve në Lushnjë, mungesës së burimeve të ligjshme për dhënien e shumës prej 900.000 lekësh, si dhe pasaktësisë në deklarimin e kursimeve *cash*, në analizë të provave në raport me faktet e konstatuara, arsyeton se:

**1.8.1** Referuar dokumentit ligjor të pronësisë, vërtetimit hipotekor nr. \*\*\*, datë 30.9.2016, i lëshuar nga ZVRPP-ja Lushnjë, rezulton se pronarë të ligjshëm të apartamentit janë vetëm prindërit e subjektit dhe znj. Arbana Selmanaj nuk figuron bashkëpronare me ndonjë pjesë takuese në këtë pasuri, pasuri e cila *de jure* është fituar me parashkrim fitues përmes vendimit gjyqësor të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Pretendimi i subjektit se e drejta e pronësisë mbi këtë apartament i ka kaluar në bazë të ligjit dhe kontratës për privatizimin e banesave, e lidhur ndërmjet Ndërmarrjes Komunale Banesave

<sup>36</sup>Vendimi i KPK-së nr. 46/2018; Vendimi i KPA-së nr. 22/2019.

dhe babait të saj, nuk qëndron, pasi ligji nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore” ka përcaktuar qartë personat përfitues nga privatizimi i banesave shtetërore, të cilët, referuar neneve 9 dhe 20 të këtij ligji, janë anëtarët madhorë të familjes sipas përbërjes familjare dhe gjendjes së strehimit që rezulton në regjistrat themeltarë të shtetasve në datën 1.12.1992.

Nga përmbajtja e akteve të administruara ka rezultuar se në datën 1.12.1992 subjekti dhe fëmijët e tjerë ka qenë minorene (17 vjeç) dhe, për rrjedhojë, nuk është përfituese e pasurisë së privatizuar për efekt të zbatimit të këtij ligji.

Në analizë të këtyre fakteve, pavarësisht marrëdhënies së posaçme familjare që ekziston mes subjektit të rivlerësimit dhe prindërve të saj, Komisioni çmon se deklarimi i subjektit për përfitimin e shumës prej 900.000 lekësh, për shkak të heqjes dorë nga bashkëpronësia e apartamentit të prindërve në Lushnjë, është i pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin.

**1.8.2** Lidhur me mungesën e të ardhurave të ligjshme të familjarëve të subjektit për dhënien e shumës 900.000 lekë, subjekti arriti të provojë faktin e punësimit të vëllait A.S në shtetin grek, për periudhën 2003 – 2011, por nuk provoi me dokumentacion të ardhurat e ligjshme të realizuara prej tij, në përputhje me kërkesat e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

**1.8.3** Sa i takon pasaktësisë në deklarimin e kursimeve *cash* në DPV-në e vitit 2016, pasi subjekti duhej të kishte deklaruar pakësim të kursimeve *cash* si burim për pagesën e këstit paraprak, Komisioni çmon se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit mbi mënyrën e konceptimit të “shtesave dhe pakësimeve” të kursimeve, nuk qëndrojnë, pasi kjo mënyrë konceptimi është në mospërputhje me detyrimet e subjektit deklarues të përcaktuara në ligjin nr. 9049/2003, i cili në mënyrë qartë kërkon që subjektet deklaruese të shprehen për ndryshimet (shtesa dhe pakësime) edhe të vlerës së likuiditeteve, gjendjes *cash* apo në llogari bankare. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë burimin e krijimit për pagesën e këstit paraprak prej 12.000 euro, sipas germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim, Komisioni, duke vlerësuar në tërësi çështjen, duke marrë në konsideratë të gjitha konstatimet e arsyetuara sa më sipër, të cilat passjellin pasaktësi në deklarimin e subjektit lidhur me burimet e ligjshme që kanë shërbyer për pagesën 12.000 euro, në raport edhe me deklarinimet e tjera që lidhen me kriterin e pasurisë, janë të një peshe të tillë që duke qëndruar edhe si një shkak i vetëm, proporcionalisht duhen çmuar si të pamjaftueshme që mund të çonin subjektin drejt aplikimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

## **2. Automjet<sup>37</sup> tip “Mercedes-Benz”, vit prodhimi 2000, e blerë në datën 25.10.2016**

Vlera e deklaruar:	200.000 lekë
Pjesa takuese:	100 %
Burimi i krijimit:	kursime nga paga

### **2.1 Hetimi i kryer nga Komisioni**

---

<sup>37</sup>Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 25.10.2016, me shitës A.Gj dhe blerëse Arbana Selmanaj, për blerjen e automjetit tip “D.C”, me targa AA \*\*\* LF, në vlerën 200.000 lekë.



DPSHTRR-ja<sup>38</sup> ka konfirmuar automjetin me targa AA \*\*\* LF, e regjistruar në pronësi të subjektit Arbana Selmanaj. Referuar praktikës së automjetit, dokumentohet blerja nga subjekti, me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 25.10.2016, në vlerën 200.000 lekë, ku ndryshimi i pronësisë dhe regjistrimi i automjetit në emër të subjektit është kryer në datën 29.3.2017.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar për këtë pasuri ka rezultuar se automjeti është blerë nga subjekti në datën 25.10.2016, në shumën 200.000 lekë, vlerë e cila është likuiduar ndërmjet palëve jashtë zyrës noteriale. Në lidhje me ndonjë trajtim preferencial të mundshëm në blerjen e këtij automjeti, nuk evidentohen problematika mbi çmimin real të blerjes së tij. Komisioni hetoi mbi mundësinë e konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit me shitësin e automjetit, ku nuk u evidentua ndonjë nga rastet e parashikuara në ligj.

## 2.2 Analiza financiare

Komisioni ka analizuar burimet e ligjshme të subjektit të cilat kanë shërbyer për blerjen e këtij automjeti për periudhën prill – tetor 2016.

Nga verifikimi i llogarive bankare në “Tirana Bank” ka rezultuar se subjekti ka tërhequr në datën 17 tetor shumën prej 500.000 lekësh nga llogaria e kursimit në emër të saj.

Në tabelën vijuese është pasqyruar analiza financiare për periudhën 2 prill – 25 tetor 2016, nga ku rezulton se kishte mundësi për blerjen e automjetit me burime të ligjshme.

Përshkrimi	Periudha 2.4.2016 – 25.10.2016
<b>Pasuri</b>	- <b>123 556</b>
Automjet blerë në datën 25.10.2016	200 000
<b>Diference likuiditeti</b>	- <b>323 556</b>
<b>Pasuri neto</b>	- <b>123 556</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>601 239</b>
Të ardhura nga paga “Tirana Bank”	601 239
<b>Shpenzime</b>	<b>245 892</b>
Shpenzime jetese	137 137
Shpenzim udhëtimi	52 755
Shpenzime qiraje Vlorë	56 000
<b>Rezultati financiar</b>	<b>478 903</b>

## 2.3 Vlerësimi i Komisionit për këtë pasuri

- ✓ Subjekti ka deklaruar saktë pasurinë, burimin e blerjes në deklaratën *Vetting*.
- ✓ Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar nga DPSHTRR-ja.
- ✓ Subjekti ka pasur mundësi financiare për të blerë automjetin me burime të ligjshme.

## 3. Llogari bankare<sup>39</sup> në “Tirana Bank”, e çelur në vitin 2011

<sup>38</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.7.2020.

<sup>39</sup>Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: nxjerrje llogarie nga “Tirana Bank”, ku vërtetohet se znj. Arbana Selmanaj disponon dy llogari me gjendje në datën 27.1.2017, në vlerën 81.802 lekë dhe 303.884 lekë, në total 385.686 lekë.

Vlera e deklaruar: 385.686 lekë  
Pjesa takuese: 100 %  
Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga

### 3.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

“Tirana Bank”<sup>40</sup> ka konfirmuar llogaritë bankare në emër të znj. Arbana Selmanaj, çelur në vitin 2011. Bashkëlidhur shkresës ndodhen lëvizjet e llogarive të subjektit nga dhjetori i vitit 2011 dhe në vazhdim, ku evidentohet kjo gjendje në llogarinë e saj bankare.

Nga verifikimi i dokumentacionit të përcjellë nga banka ka rezultuar se gjendja në llogarinë e subjektit është e njëjtë me atë të deklaruar prej saj në deklaratën *Vetting* dhe se të ardhurat e pagës kanë qenë burim për krijimin e gjendjes.

### 3.2 Vlerësimi i Komisionit

Nga analizimi i të dhënave bankare nuk evidentohen problematika, deklarimi përputhet me të dhënat e ardhura nga banka.

## 4. Apartament në përdorim, në Vlorë

Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka shpjeguar se: *“Në periudhën dhjetor 2016 – mars 2019 kam përdorur për qëllime banimi, pa kundërshpërblim, shtëpinë e shtetasve G dhe K. Gj, të ndodhur lagjen ‘\*\*N’, rruga ‘H.A’, kati i tretë i pallatit përballë ndërtesës së njohur si ‘shtëpia e ish-oficerëve’, Vlorë. Gjatë kohës që kam banuar në këtë apartament nuk kam paguar qira”*.

Këtë fakt subjekti e ka dokumentuar me deklaratën noteriale<sup>41</sup>, datë 20.1.2021, të shtetasit K. Gj, i cili ka deklaruar se: *“Znj. Arbana Selmanaj është kujdesur dhe ka përdorur për qëllime banimi, për një periudhë afërsisht 2 vjet, njërin prej apartamenteve që kam në pronësi, apartamenti me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*, f.\*\*\*, z. k. \*\*\*”*. Subjekti i bashkëlidhur deklaratës edhe certifikatën e pronësisë së këtij apartamenti me sip. 70 m<sup>2</sup>, ku pronar i pasurisë është shtetasi K.Gj.

Komisioni ka pyetur<sup>42</sup> subjektin mbi arsyet e dhënies pa kundërshpërblim të apartamentit nga shtetasi K.Gj dhe marrëdhënien që ka me të, për të cilën ka shpjeguar se<sup>43</sup>: *“Kam përdorur rreth dy vjet shtëpinë e shtetasve K dhe G.Gj për qëllime banimi me të cilët kemi miqësi familjare prej shumë vitesh”*.

4.1 Komisioni hetoi mbi ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit me pronarët e apartamentit, shtetasit K dhe G.Gj, dhe nga dokumentacioni i administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë<sup>44</sup> rezultoi se subjekti, gjatë ushtrimit të funksionit si gjyqtare, nuk ka pasur çështje gjyqësore të shqyrtuara me këta shtetas.

### 4.2 Lidhur me mënyrën e fitimit të kësaj pasurie

<sup>40</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.7.2020.

<sup>41</sup>Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 20.1.2020.

<sup>42</sup>Përmes e-mail-it datë 23.9.2021.

<sup>43</sup>Me e-mail-in datë 6.10.2021, në përgjigje të pyetësorit datë 23.9.2021.

<sup>44</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2021.

Nga hetimi i kryer, nga të dhënat e gjeneruara nga sistemi i ASHK-së, shtetasi K.Gj rezulton pronar i dy pasurive të llojit “apartament”, me sip. 70 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në rrugën “H. A”, Vlorë, njëri prej të cilëve është apartamenti në përdorim nga subjekti.

Subjekti ka depozituar dokumentacion<sup>45</sup> mbështetës mbi mënyrën e fitimit të kësaj pasurie nga shtetasi K.Gj, ku rezulton se ky shtetas ka prenotuar blerjen e apartamentit në vitin 2003, nëpërmjet kontratës së prenotim shitjes nr. \*\*\*, datë 27.5.2003, ku në përmbajtje të saj përcaktohet pagesa me këste dhe kësti i fundit duhet të paguhej në vitin 2004. Akti i shitblerjes është finalizuar me nr. \*\*\*, në datën 9.11.2013.

#### **4.3 Konstatime të Komisionit lidhur me banesën në përdorim**

- Subjekti ka deklaruar saktë apartamentit në Vlorë, në përdorim.
- Referuar aktit noterial, sipas të cilit apartamentit është prenotuar nga shtetasi K.Gj në vitin 2003 (para se subjekti të emërohej në detyrën e gjyqtares në vitin 2007).
- Nuk u evidentua ndonjë situatë konflikti interesi ndërmjet subjektit dhe pronarëve të apartamentit të dhënë në përdorim.

Komisioni evidentoi si të paqartë marrëdhënien e subjektit me pronarët e apartamentit për përdorimin, pa shpërblim, të apartamentit për rreth dy vjet. Në seancën dëgjimore të datës 13.12.2021, subjekti u pyet nga trupi gjykues lidhur me marrëdhënien e saj me pronarët e apartamentit, ku deklaroi se këta shtetas kishin marrëdhënie të ngushtë me hallën e saj, e cila prej disa ditësh kishte ndërruar jetë.

#### **4.4 Vlerësimi i Komisionit**

Në vlerësim të të gjithë akteve ligjore dhe fakteve të dala gjatë hetimit, si dhe deklarimeve të subjektit se nga viti 2011<sup>46</sup> dhe në vijim ushtron detyrën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka deklaruar se ka banuar me qira në adresa të ndryshme në qytetin e Vlorës, si vijon:

- në lagjen “\*\* N”, rruga “L.S”, Vlorë, në periudhën dhjetor 2011 – dhjetor 2014, me qira 9.000 lekë/ muaj;
- në lagjen “Pavarësia” në Vlorë, në periudhën janar 2015 – nëntor 2016, me qira 8.000 lekë/muaj;
- në lagjen “\* N”, rruga “H.A”, në periudhën dhjetor 2016 – mars 2019 (kjo adresë i përket apartamentit të përdorur nga subjekti, pa kundërshpërblim, pronë e shtetasit K.Gj, e cila është trajtuar më sipër).

Nisur nga faktet vijuese:

- Subjekti ka përdorur këtë pasuri për banim në periudhën dhjetor 2016 – mars 2019.
- Nisur nga aktet ligjore lidhur me origjinën e pronës, ku referuar kontratës së shitblerjes rezulton se pronari i apartamentit K.Gj ka likuiduar blerjen e këtij apartamenti që në vitin 2003, para se subjekti të emërohej në detyrën e gjyqtares (në vitin 2007), si dhe shumë vite para se të emërohej në detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë (në nëntor të vitit 2011).

<sup>45</sup>Dokumentacion i depozituar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit datë 13.10.2021, i protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2021, si vijon: kontratë prenotimi shitjeje me nr. \*\*\*, datë 27.5.2003; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 9.11.2013.

<sup>46</sup>Ka ushtruar detyrën si gjyqtare nga nëntori i vitit 2011 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

**Përfundimisht, Komisioni krijoi bindjen se apartamenti në përdorim nuk mund të jetë pasuri e fshehur e subjektit dhe nisur nga faktet e sipërcituara subjekti ka deklaruar saktë pasurisë në përdorim, në përputhje me nenin D/5 të Aneksit të Kushtetutës.**

## **5. GJETJE TË TJERA TË REZULTUARA NGA KOMISIONI**

5.1 Komisioni verifikoi të dhënat e përcjella nga sistemi *TIMS*<sup>47</sup> në lidhje me personat me të cilët ka udhëtuar jashtë territorit të Shqipërisë, si dhe nga verifikimi i kryer pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Tiranë<sup>48</sup>, nga verifikimet e targave në sistemin e AMF-së dhe informacionit të gjeneruar nga sistemi *TIMS* nuk u evidentuan problematika lidhur me këto automjete dhe personat me të cilët subjekti ka udhëtuar jashtë territorit të Shqipërisë.

5.2 Lidhur me banesat në përdorim, të deklaruara nga subjekti, ndër vite

Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka shpjeguar në mënyrë të detajuar adresat e banesave ku ka jetuar me qira në periudha kohore të ndryshme, si vijon:

- Në periudhën shtator 2006 – shtator 2007<sup>49</sup> subjekti ka deklaruar si adresë banimi rr. “*Beqir Luga*” \*\*\*, Tiranë, ku ka banuar së bashku me dy miket e konviktit B(Gj) B dhe Gj.Gj, me qira në vlerën 24.000 lekë/muaj, të cilat i ndanim në mënyrë të barabartë.

Për të provuar këtë fakt subjekti ka depozituar një deklaratë të datës 16.1.2020, të shtetasës B (Gj) B, e cila ka konfirmuar se ka jetuar në të njëjtën banesë me subjektin, ndodhur pas ATSH-së, rruga “*Beqir Luga*”, p. \*, kati \*. Deklarata mban vërtetim nënshkrimi nga noteri, me nr. \*\* rep., datë 16.1.2020.

- Në periudhën gusht 2007 – nëntor 2011<sup>50</sup> subjekti ka deklaruar se ka banuar me qira në Tiranë, në një apartament në katin e katërt të pallatit të Piktorit të Popullit A.B, me qira 20.000 lekë/në muaj, ku për një periudhë kohe ka jetuar edhe vëllai i saj G.S, në periudhën gusht 2007 – tetor 2009, kur ka qenë student dhe në shkurt 2011 – nëntor 2011.

Subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale me nr. \*\*\*, datë 16.1.2020, të vëllait G.S, i cili ka deklaruar se: “*Ka banuar së bashku me Arbana Selmanaj në një apartament që ndodhet në zonën e M, në Rrugën e Dibrës, në adresën: rr. ‘F.Xh’, sot A.K. Qiraja paguhej nga motra ime, 20.000 lekë/muaj*”.

- Nga viti 2011<sup>51</sup> dhe në vijim ka deklaruar se ka banuar me qira në adresa të ndryshme në qytetin e Vlorës, pasi ushtron detyrën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, si vijon:
  - në lagjen “\*\* Nëntori”, rruga “L.S”, në periudhën dhjetor 2011 – dhjetor 2014, me qira 9.000 lekë/muaj, të cilën e dokumenton përmes deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 21.1.2020, të shtetasit A.L, pronar i pasurisë apartament me sip. 74 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, vol. \*\*, f. \*\*;
  - në lagjen “Pavarësia” të qytetit të Vlorës, në periudhën janar 2015 – nëntor 2016, me qira 8.000 lekë/në muaj, në banesën e shtetasës V.F;
  - në lagjen “\*\* Nëntori”, rruga “H.A.”, kati i tretë i pallatit përballë ndërtesës së njohur si “shtëpia e ish-oficerëve”, në periudhën dhjetor 2016 – mars 2019 (kjo adresë i përket

<sup>47</sup>Informacion i përcjellë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2021, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

<sup>48</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2021.

<sup>49</sup>Kur subjekti ka ushtruar detyrën si gjyqtare stazhiere në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

<sup>50</sup>Kur subjekti ka ushtruar detyrën si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë.

<sup>51</sup>Kur subjekti ka ushtruar detyrën si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

apartamentit të përdorur nga subjekti, pa kundërshtim, pronë e shtetasit K. Gj, e cila është trajtuar më sipër);

- nga muaji prill 2019 e në vijim subjekti ka deklaruar banimin në adresën: lagjja “\*\* Nëntori”, rruga “H.Ç”, banesë e shtetasve K e A.B, me qira 12.000 lekë/në muaj. Kjo marrëdhënie qiraje është formalizuar me kontratën e qirasë nr. \*\*, datë 30.11.2019, e nënshkruar ndërmjet qiradhënësve K dhe A.B dhe qiramarrëses Arbana Selmanaj.

Në vijim të sa më sipër, subjekti ka shpjeguar se: *“Për çdo vit, gjatë pushimeve vjetore të verës dhe të vitit të ri, kam qëndruar pranë prindërve në banesën e tyre në qytetin e Lushnjës, lagjja ‘L. Dh’, pallati \*\*, apartamenti nr. \*”.*

Komisioni hetoi mbi mundësinë e një konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me qiradhënësit e banesave në përdorim, nga viti 2011 dhe në vijim. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë<sup>52</sup>, në bazë të kërkesës së Komisionit, ka informuar se subjekti, gjatë ushtrimit të funksionit si gjyqtare, nuk ka pasur çështje gjyqësore të shqyrtuara me këta shtetas.

### **Vlerësimi i Komisionit**

Nga hetimi i kryer nuk u evidentuan problematika lidhur me banesat e marra me qira, të cilat përputhen me deklaratimet periodike ndër vite të kryera nga subjekti. Nuk u evidentua ndonjë situatë konflikti interesi ndërmjet subjektit me qiradhënësit e banesave nga viti 2011 dhe në vijim. Përfundimisht, nga Komisioni nuk u ngritën dyshime për pasuritë në përdorim.

**5.3 Komisioni hetoi në lidhje me automjetin tip “F. F”, viti i prodhimit 1994, blerë nga subjekti në datën 7.3.2007, në vlerën 250.000 lekë dhe hequr nga qarkullimi në datën 30.6.2015.**

### **Vlerësimi i Komisionit**

Nga verifikimi i kryer ka rezultuar se deklaratimet e subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar nga DPSHTRR-ja<sup>53</sup>.

## **Analiza financiare përmbledhëse për periudhën 2004 – 2016**

---

<sup>52</sup>Me shkresën nr. \*\* prot., datë 17.9.2021.

<sup>53</sup>Me shkresën nr. \*\* prot, datë 15.7.2020

Pershkrimi	2004-2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>Pasuri</b>	<b>639 542</b>	<b>211 836</b>	<b>- 23 761</b>	<b>53 331</b>	<b>- 16 235</b>	<b>- 25 089</b>	<b>27 664</b>	<b>183 162</b>	<b>268 247</b>	<b>665 739</b>	<b>1 778 549</b>
Automjet "Ford"		250 000									
Pagese kesti I per Apartamentin											1 623 240
Automjet Fiat											200 000
<b>Diference Likuiditeti</b>	<b>639 542</b>	<b>- 38 164</b>	<b>- 23 761</b>	<b>53 331</b>	<b>- 16 235</b>	<b>- 25 089</b>	<b>27 664</b>	<b>183 162</b>	<b>268 247</b>	<b>665 739</b>	<b>- 44 691</b>
Likuiditete ne fund te vitit	<b>639 542</b>	<b>601 378</b>	<b>577 617</b>	<b>630 948</b>	<b>614 713</b>	<b>589 624</b>	<b>617 288</b>	<b>800 450</b>	<b>1 068 697</b>	<b>1 734 436</b>	<b>1 689 745</b>
Depozitë Bankare	200 000										
Gjendje Cash	600 000	600 000	600 000	600 000	600 000	600 000	600 000	800 000	800 000	1 340 000	1 340 000
Likuiditete ne banke 2 prill 2016	39 542	1 378	- 22 383	30 948	14 713	- 10 376	17 288	450	268 697	394 436	349 745
Detyrime	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>Pasuri neto</b>	<b>639 542</b>	<b>211 836</b>	<b>- 23 761</b>	<b>53 331</b>	<b>- 16 235</b>	<b>- 25 089</b>	<b>27 664</b>	<b>183 162</b>	<b>268 247</b>	<b>665 739</b>	<b>1 778 549</b>
<b>Te ardhura</b>	<b>1 127 825</b>	<b>770 911</b>	<b>845 091</b>	<b>903 346</b>	<b>888 936</b>	<b>889 513</b>	<b>866 300</b>	<b>858 313</b>	<b>1 052 560</b>	<b>1 098 932</b>	<b>1 025 770</b>
Te ardhura nga paga	1 127 825	770 911	845 091	903 346	888 936	889 513	866 300	858 313	1 052 560	1 098 932	1 025 770
<b>Shpenzime</b>	<b>397 670</b>	<b>379 968</b>	<b>401 257</b>	<b>431 488</b>	<b>376 620</b>	<b>373 918</b>	<b>334 253</b>	<b>385 028</b>	<b>389 646</b>	<b>327 159</b>	<b>375 847</b>
Shpenzime jetese	312 978	235 968	136 620	136 620	136 620	136 620	141 024	141 024	219 998	224 276	235 092
Shpenzim udhetimi	52 692		24 637	54 868	-	8 298	85 229	136 004	61 648	6 883	52 755
Shpenzime qiraje Tirane	32 000	144 000	240 000	240 000	240 000	220 000					
Shpenzime qiraje Vlore						9 000	108 000	108 000	108 000	96 000	88 000
<b>Rezultati Financiar</b>	<b>90 613</b>	<b>179 107</b>	<b>467 595</b>	<b>418 527</b>	<b>528 551</b>	<b>540 684</b>	<b>504 383</b>	<b>290 123</b>	<b>394 667</b>	<b>106 035</b>	<b>- 1 128 627</b>

## Konkluzion përfundimtar mbi pasurinë

Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit ka rezultuar se subjekti ka deklaruar saktë pasurinë në deklaratën *Vetting* dhe nuk janë konstatuar elemente që mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë.

Komisioni, duke vlerësuar në tërësi çështjen, për një vlerësim sa më objektiv, duke marrë në konsideratë të gjitha konstatimet e arsyetuara sa më sipër, të cilat passjellin pasaktësi në deklarimin e subjektit lidhur me burimet e ligjshme që kanë shërbyer për pagesën 12.000 euro, në raport edhe me deklaratimet e tjera që lidhen me kriterin e pasurisë, si dhe në vlerësim të përgjithshëm të dy kritereve të tjera të rivlerësimit, Komisioni çmon se proporcionalisht këto konstatime, si një shkak i vetëm dhe i veçuar, nuk janë të mjaftueshme për t'u konsideruar si deklarim i pamjaftueshëm dhe që mund të çonte subjektin drejt aplikimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

## B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

DSIK-ja ka dërguar një raport<sup>54</sup> në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të znj. Arbana Selmanaj*.

## Hetimi i kryer nga Komisioni

Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës, si dhe verifikoi një informacion të dërguar nga autoritetet verifikuese.

<sup>54</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, i deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.10.2021, të KDZH-së.

Komisioni administroi dhe verifikoi çështjen gjyqësore përkatëse, ku subjekti ka qenë pjesë e trupit gjykues në këtë çështje.

- ✓ Nga analizimi i dosjes nuk rezultuan fakte që mund të përbëjnë prova në lidhje me sa pretendohet në informacione të ardhura.

Gjithashtu, u kërkua informacion pranë Prokurorisë së Përgjithshme për procedime të iniciuara ndaj subjektit të rivlerësimit Arbana Selmanaj, nga ku rezultuan 5 kallëzime penale të regjistruara pa autor, për veprën penale “shpërdorim detyre”, të parashikuara nga neni 248 i Kodit Penal. Në 4 kallëzime është vendosur “mosfillimi i procedimit penal” dhe në një prej tyre është vendosur “pushimi i procedimit penal”, pasi faktet nuk parashikoheshin nga ligji si vepra penale.

Nga hetimi i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës nuk u provua në ndonjë formë që subjekti i rivlerësimit të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, nuk është i përfshirë, si dhe nuk është i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar.

### **Vlerësimi i Komisionit për kontrollin e figurës**

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në analizimin e:

- raportit<sup>55</sup> të aftësive profesionale të kryer nga KLGJ-ja;
- denoncimeve të paraqitura sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016; si dhe
- kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Raporti i KLGJ-së është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- i) formularit të vetëdeklarimit, të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit;
- ii) të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së; si dhe
- iii) 5 dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

### **i. Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit**

Formulari i vetëdeklarimit paraqitet i plotësuar sipas përcaktimeve ligjore.

### **ii. Të dhëna nga burime arkivore të KLGJ-së**

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se gjyqtarja Arbana Selmanaj ka marrë titullin “jurist” nga Universiteti i Tiranës, në datën 5.7.2002 dhe titullin “magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2007.

---

<sup>55</sup>Me nr. \*\*\* prot., datë 25.11.2019.

Në datën 14.11.2007 është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe në vijim, më 14.11.2011, emërohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku vazhdon aktualisht.

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore për periudhën e kërkuar, nuk rezultojnë që ndaj gjyqtarës Arbana Selmanaj të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor apo të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

**iii. Nga analizimi i 5 dosjeve të zgjedhura me short**, sipas kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë rezultuar si vijon:

## **1. Aftësitë profesionale**

### *a) Njohuritë ligjore*

Subjekti i rivlerësimit Arbana Selmanaj ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në aktet e vëzhguara është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në disa raste kualifikon drejt marrëdhënien juridiko-civile, objekt shqyrtimi gjyqësor, dhe identifikon rastet kur, për sqarimin e fakteve që kanë lidhje me mosmarrëveshjen, duhen njohuri të posaçme, duke thirrur ekspertët e fushës. Zgjidh drejt mosmarrëveshjet objekt gjykimi dhe vendimi i dhënë prej saj lihet në fuqi nga gjykatat më të larta ose nuk ankimohet nga palët. Bën cilësim të saktë të veprës penale dhe është korrekte në zgjedhjen e llojit të masës së dënimit që duhet të caktohet ndaj të pandehurit të deklaruar fajtor, duke respektuar kriteret e parashikuara nga neni 47 i Kodit Penal. Gjithashtu, respekton masën e dënimit që parashikon neni 51 i Kodit Penal, në rastin e të pandehurit të mitur të deklaruar fajtor. Njeh dhe zbaton alternativat e dënimit me burgim.

*Në të drejtën procedurale penale*, gjyqtarja respekton të drejtën e të pandehurit për të pasur avokat mbrojtës në gjykim, merr masa dhe garanton të drejtën e të miturit për të pasur domosdoshmërisht avokat edhe kur ai nuk e ka zgjedhur vetë një të tillë, madje siguron edhe prezencën e prindit gjatë gjykimit të një të mituri, aplikon kur është rasti gjykimin e posaçëm (gjykimin e shkurtuar), si dhe ka njohuri të mira në caktimin e masave të sigurimit personal.

*Në të drejtën civile e procedurale civile*, gjyqtarja njeh dhe zbaton drejt dispozitat e Kodit Civil mbi shpërblimin e dëmit, si ato për dëmin material, ashtu edhe për dëmin jopasuror apo moral, ndërkohë që shfaq njohuri të mira lidhur me padinë e rivendikimit të sendit, por edhe lidhur me pavlefshmërinë e titujve ekzekutivë.

*Në të drejtën familjare*, njeh dhe zbaton saktë dispozitat e Kodit të Familjes mbi kujdestarinë e fëmijëve të mitur, veçanërisht në rastet kur kanë ndryshuar kushtet lidhur me caktimin e kujdestarit, merr mendimin e psikologut para se të vendosë për të miturin dhe respekton të drejtën e takimit të prindit tjetër me fëmijën.

Ndër 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, janë ankimuar 3 prej tyre dhe në të trija rastet vendimi i dhënë nga gjyqtarja Arbana Selmanaj është lënë plotësisht në fuqi nga Gjykata e Apelit, ndërsa pesë vendime kanë marrë formë të prerë, pa u ankimuar nga palët.

### *b) Arsyetimi ligjor*



Subjekti i rivlerësimit Arbana Selmanaj ka aftësi shumë të mira në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të arsyetuara prej saj janë të qarta, të kuptueshme, zgjidhja në themel e çështjes jepet e argumentuar, provat e marra në shqyrtim jo vetëm citohen, por edhe tregohet se çfarë u provua me përmbajtjen e tyre. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirës, i jepet përgjigje ligjore pretendimeve apo prapësimeve/kundërshtimeve të palëve të parashtruara gjatë gjykimit. Respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme, e mirorganizuar dhe e standardizuar. Në nxjerrjen e konkluzioneve subjekti i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Vendimet e ndërmjetme shoqërohen gjithnjë me referencë ligjore dhe kur duhet jepen arsye për dhënien e tyre.

## **2. Aftësitë organizative**

### *a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*

Subjekti i rivlerësimit Arbana Selmanaj, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Ajo ka deklaruar se i janë caktuar për gjykim gjithsej 1.200 çështje dhe ka përfunduar 1.237 çështje (37 janë çështje të mbartura në periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016), duke mbartur vitin e fundit 114 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna, është 95 %.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë konstatohet se për periudhën e rivlerësimit gjyqtarja Arbana Selmanaj ka përfunduar 1.189, nga të cilat 396 çështje civile themeli + 63 familjare, 246 çështje penale themeli (krime + kundërvajtje), 245 kërkesa civile, 146 penale masa sigurimi dhe 142 kërkesa penale.

Subjekti ka punuar në një gjykatë të organizuar në seksione, por ndërkohë, gjatë periudhës objekt i këtij vlerësimi profesional, ajo ka punuar njëkohësisht në dy seksione, në seksionin civil dhe në atë penal për të miturit. Si rezultat, vlerësimi i aspektit organizativ të punës së gjyqtares do të kryhet në përputhje me parashikimin e germës “g”, të pikës 3, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

Në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, që nuk është e organizuar në seksione, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 çështje, penale (krime + kundërvajtje penale) dhe civile që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje me palë kundërshtare. Ky rregull nënkupton një ngarkesë sasiore prej jo më pak se 600 gjykime çështjesh të tilla për 3 vjet.

Sipas të dhënave të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, që shoqërojnë formularin e vetëvlerësimit, rezulton se gjyqtarja Arbana Selmanaj, në vitet 2013 - 2016 ka gjykuar 246 çështje penale (krime + kundërvajtje) dhe 459 çështje civile me palë kundërshtare. Rrjedhimisht, ajo ka pasur ngarkesë sasiore mbi standardin sasior të paracaktuar.

Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja Arbana Selmanaj ka qenë në intervale kohore nga 1 ditë (dosja 2) deri në 5 muaj e 16 ditë (dosja 3). Në tre dosjet e tjera kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 1 muaj e 14 ditë (dosja 1), 2 muaj e 23 ditë (dosja 4) dhe 12 ditë (dosja 5).

Në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se në të gjitha rastet është respektuar afati ligjor ose afati standard i gjykimit, duke dëshmuar se gjyqtarja Arbana Selmanaj i kushton rëndësi

respektimit të afatit kohor të arsyeshëm në gjykimin e çështjeve, si pjesë e procesit të rregullt ligjor.

Për sa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve në 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, u konstatua se në dokumentet 1 dhe 3 nuk është respektuar afati standard i gjykimit, për të cilat nuk dihen shkaqet e mosrespektimit të këtij afati, ndërsa në dokumentin 2 është respektuar afati standard.

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja Arbana Selmanaj i ka kushtuar rëndësi arsytimit në kohën e duhur vendimeve gjyqësore, duke respektuar në 4 rastet afatet ligjore. Konkretisht, arsytimi i vendimeve është kryer për 1 ditë nga shpallja (dosja 1), për 4 ditë nga shpallja (dosja 2), për 3 ditë nga shpallja (dosja 3) dhe për 7 ditë nga shpallja (dosja 5).

Vetëm në një rast është tejkaluar me 11 ditë afati ligjor për arsytimin e vendimit (dosja 4). Në këtë rast konstatohet se palët nuk e kishin ankimuar vendimin e dhënë nga gjyqtarja, për pasojë, nuk është dëmtuar procesi i ankimit.

Gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit për gjyqtaren Arbana Selmanaj janë paraqitur gjithsej 10 ankesa në Inspektoratin e ish-KLD-së (shihni të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së si më sipër), ku pas verifikimit të tyre nuk ka rezultuar asnjë shkelje ligjore.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Arbana Selmanaj është eficient dhe efektive në çështjet që ajo ka shqyrtuar. Respektimi i kohës në gjykim përbën një aspekt të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor. Në efektivitetin dhe eficientësinë e veprimtarisë së saj mund të ketë ndikuar edhe ngarkesa sasiore e lartë në gjykim. Në shumicën e rasteve gjykimet kanë përfunduar brenda afateve të arsyeshme. Gjithashtu, gjyqtarja i ka kushtuar rëndësi edhe kohës së arsytimit të vendimeve gjyqësore, ku në shumicën e rasteve afatet ishin respektuar.

#### *b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore*

Subjekti i rivlerësimit Arbana Selmanaj ka shfaqur aftësitë e duhura për të kryer procedurat gjyqësore në 5 dosjet e vëzhguara, të cilat janë shqyrtuar pa vonesa prej saj, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore/pajtimit apo gjyqësore.

Në 3 çështje civile themeli të vëzhguara, njëra prej tyre familjare, gjyqtarja ka kryer rregullisht veprimet përgatitore, të dokumentuara me procesverbal. Aftësi shumë të mira janë konstatuar edhe në gjykimet penale.

Nga dosjet e vëzhguara, gjykimet kanë përfunduar me 3 seanca (dosja 1), 1 seancë (dosja 2), 8 seanca (dosja 3), 5 seanca (dosja 4) dhe me 2 seanca (dosja 5). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar 19 seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm 3 seanca kanë qenë joproduktive. Pengesë në 3 seanca gjyqësore joproduktive janë bërë: mungesat e palëve në dy seanca (dosja 3) dhe mosplotësimi i rregullt i aktit të përfaqësimit në një seancë (dosja 4), ndërsa 16 seancat e tjera kanë qenë produktive. Pra, 3 seanca joproduktive kanë dështuar për shkaqe objektive e të pavarura nga vullneti i gjyqtarës.

Seancat e vëzhguara përgjithësisht janë çelur sipas planifikimit, duke respektuar orarin e fillimit të tyre, por evidentohen edhe rastet kur seancat kanë filluar me disa minuta vonesë, deri në 30 minuta.

Për t'u vlerësuar është fakti që seancat gjyqësore janë regjistruar në audio, në funksion të transparencës së gjykimit, me përjashtim të një dosjeje (dosja 4), që i përket vitit 2013, periudhë në të cilën ende nuk ishte instaluar ai sistem.

*c) Aftësia për të administruar dosjet*

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në çdo dosje të vëzhguar gjyqtarja ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si kërkesëpapia apo kërkesa penale për gjykim, procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim apo vendimet përfundimtare, fletëthirrjet, provat, vendimi përfundimtar, etj. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit. Në të 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara janë inventarizuar aktet procedurale.

### **3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

*a) Etika në punë*

Gjyqtarja Arbana Selmanaj ka marrë titullin “jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 5.7.2002 dhe titullin “magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2007. Në datën 14.11.2007 është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe në vijim, më 14.11.2011, është emëruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku vazhdon edhe aktualisht.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Arbana Selmanaj. Dy ankesa të regjistruara për shkelje etike në vitin 2016, pas verifikimit të kryer, rezultuan të pabazuara. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

*b) Integriteti*

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Arbana Selmanaj dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

*c) Paanësia*

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Arbana Selmanaj dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit. Asnjë prej dosjeve nuk trajton çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Gjithashtu, nuk janë konstatuar raste të mosrespektimit të rregullave procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme. Në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e gjyqtarës nga gjykimi i çështjeve.

### **4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

*a) Aftësitë e komunikimit*

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja Arbana Selmanaj, komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, në seancat përgatitore dhe gjyqësore. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve.

*b) Aftësia për të bashkëpunuar*

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar vonesa të theksuara në arsyetimin e vendimeve, gjë që tregon se bashkëpunimi i saj me administratën gjyqësore dhe kolegët në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur.

*c) Gatishmëria për t'u angazhuar*

Subjekti i rivlerësimit Arbana Selmanaj i është nënshtruar detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Ajo ka shfaqur interes për të marrë pjesë në aktivitete trajnuese, si në ato të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, por edhe nga institucione të tjera, për të plotësuar më së miri formimin e saj profesional dhe etik.

### **Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni**

Komisioni, pas rivlerësimit të raportit të kryer nga KLGJ-ja, nuk gjeti *indicie* apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale.

### **DENONCIMET**

Për subjektin e rivlerësimit Arbana Selmanaj janë depozituar në total 4 denoncime, të cilat u analizuan nga Komisioni dhe në 3 prej tyre nuk rezultuan fakte apo rrethana të cilat mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e vlerësimit, në aspektin profesional.

#### **1. Lidhur me denoncimin e shtetasit me iniciale K. L.**

Ky shtetas informon se ka kallëzuar penalisht një firmë ndërtimi për një objekt shumëkatësh pranë xhamisë së madhe në qytetin e Vlorës. Nga ky kallëzim janë arrestuar administratori i firmës së ndërtimit, ish-kryebashkiaku i Vlorës, z. Sh. Gj., si dhe bashkëpunëtorë të tjerë.

Sipas denoncuesit, trupi gjykues, ku në përbërje ka qenë gjyqtarja Arbana Selmanaj, ka vendosur lirimin me detyrim paraqitjeje për këta shtetas, të akuzuar për disa vepra penale, si mashtrim e falsifikim dokumentesh në dhënien e lejeve për ndërtime të paligjshme, duke iu referuar edhe procesit të heqjes së sekuestros (preventive) dhe lirimin e pallatit shumëkatësh të ndërtuar në qendër të Vlorës. Duke pretenduar gjithashtu se Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur pafajësinë për këta shtetas.

Komisionit, referuar vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i rezultoi se ish-kryebashkiaku është akuzuar për 4 vepra penale dhe gjykata, ndër të tjera, ka vendosur:

- Deklarimin fajtor për ish-kryebashkiakun për 2 vepra penale, konkretisht “falsifikim dokumentesh”, dënimin e tij me 4 vjet dhe për veprën penale “veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës” me 1 vit burg; konvertimin e dënimit në 2 vjet shërbim prove dhe ndalimin e ushtrimit të funksioneve publike për 3 vjet.
- Për administratorin e firmës është vendosur deklarimi fajtor për veprën penale “falsifikim i dokumenteve” dhe dënimi me 3 vite burgim; konvertimin e këtij dënimi me 3 vjet shërbim prove.

Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 27.7.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me këto ndryshime:

- Prishjen e vendimit të mësipërm dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të këtyre shtetasve.

Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime lidhur me këtë çështje, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit**

Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se lidhur me themelin të kësaj çështjeje penale, ajo ka qenë pjesë e trupës gjyqësore dhe me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.7.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur dënimin e të pandehurve Sh.Gj dhe A.H, si dhe konfiskimin e dy objekteve, për të cilat më parë ishte vendosur sekuestrimi i tyre.

### **Vlerësimi i Komisionit**

Nga analizimi i çështjes në tërësi nuk u provuan pretendimet e ngritura nga denoncuesi.

2. Komisioni, nëpërmjet një artikulli të bërë publik në median *online*<sup>56</sup>, ka marrë dijeni mbi një inspektim të kryer nga ish-KLD-ja ndaj gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe të Apelit Vlorë, mbi lirimimin njëri pas tjetrit të 7 të dyshuarve për 15 tonë hashash, të arrestuar gjatë muajit korrik të vitit 2017 në fshatin D, Llakatund.

Për nevoja të hetimit administrativ, Komisioni ka kërkuar informacion pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë) mbi rezultatet e inspektimit të kryer.

KLJG-ja<sup>57</sup> ka përcjellë dosjen përkatëse të inspektimit të kryer, përmes së cilës Inspektorati i ish-KLD-së, me vendimin nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2018, ka vendosur mbylljen e hetimit disiplinor ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarëve të hetuar, midis të cilëve edhe gjyqtarja Arbana Selmanaj, duke mos konstatuar asnjë shkelje ligjore për gjyqtaren në vendimmarrjet e saj, që mund të përbëjë shkelje disiplinore, në kuptim të nenit 140/2 të Kushtetutës.

### **Vlerësimi i Komisionit**

Nga verifikimi i kryer lidhur me këtë çështje nuk u evidentua ndonjë shkelje ligjore e kryer nga subjekti i rivlerësimit apo të ketë kryer ndonjë veprim që cenon figurën apo aftësitë e saj profesionale.

### **Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale**

Nga hetimi i thellë administrativ i kryer nuk u provua asnjë *indicie* apo element që cenon figurën e gjyqtarës Arbana Selmanaj dhe sipas parashikimeve të nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është efiçente dhe efektive në masë të pranueshme dhe, përfundimisht, u vlerësua për kriterin profesional “e aftë”.

## **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi

<sup>56</sup>CAN- C.N.A.

<sup>57</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2021.

dëgjoi subjektin në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Arbana Selmanaj ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Arbana Selmanaj, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtar dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më 15.12.2021.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Brunilda BEKTESHI**  
**Kryesuese**

**Suela ZHEGU**  
**Relatore**

**Firdes SHULI**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Etmonda Hoxha*